

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil**, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ahmet Idrizaj - Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi – anëtar të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile të paditësit Z. (G.) B., nga fshati P., Komuna e Gj., (tani me vendbanim në Gj.), i përfaqësuar nga i autorizuari i tij Muharrem Hadri avokat në Gjakovë, kundër të paditurës A. B. (e vajzërisë H.), në adresën F. alle 6 Bei – H. 81476 M. - G., për : zgjidhje të martesës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor jo publik, të mbajtur me datë 24.05.2018, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të të paditurës, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**ZGJIDHET** martesë e lidhur në mes të paditësit Z.(G.) B., nga fshati P., Komuna e Gj., kundër të paditurës A.B. (e vajzërisë H.), në adresën F. alle 6 Bei – H. 81476 M. - G., e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në fshatin S., Komuna e Gj., me datë ..., nën nr. rendor ..., me nr. të referencës 2/..., në kuptim të nenit 68 pika 1, të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## **A r s y e t i m**

Paditësi në këtë gjykatë me datë 03.08.2017, ka parashtruar padi për zgjidhjen e martesës me këtu të paditurën si dhe nëpërmes të autorizuarit të tij, gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje ka potencuar faktin se : paditësi me të paditurën kanë lidhur martesë me datë 14.07.2011, në fshatin S. , Komuna e G. Marrëdhëniet në mes të bashkëshortëve të cilat kanë përfunduar me shkëputjen finale të bashkësisë faktike martesore, ashtu që në rastin konkret paditësi dëshiron që edhe formalisht të e zgjidh martesën e lidhur në mes të palëve në procedurë.

I autorizuari i paditëses në fjalën e tij përfundimtare deklarojë se: në bazë të provave të administruara, në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar fakti se palët në procedurë bashkësinë faktike martesore e kanë shkëputur në një periudhë kohore më shumë se dy vite. Gjatë bashkësisë së tyre martesore, palët në procedurë nuk kanë pasur fëmijë të përbashkët, andaj në këtë kontekst nuk ka shansa që bashkësia martesore të rikthehet, për cka edhe janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e martesës në mes të palëve në procedurë dhe për këtë arsye gjykatës i propozojë që kërkesëpadia e paditësit të miratohet në tërësi si e themeltë.

Nuk kërkojë shpenzime procedurale.

Gjykata në mbështetje të nenit 423 par. 4, të LPK-së, shqyrtimin kryesor, e mbajti në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt, me ç'rast pas vlerësimit të fakteve - juridike relevante, çmuarjes me ndërgjegje të provave të zbatuara dhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit, e në pajtim me nenin 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u miratua.

Nga provat e zbatuara është argumentuar gjendja faktike si në vijim:

Nga Certifikatë martesë me nr. rendor ... me nr. të referencës 2/... e lëshuar me datë 24.05.2018, në Zyrën e Gjendjes Civile në Gj., rezulton se këtu palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me datë 14.07.2011 në zyrën e Gjendjes Civile në fshatin S., Komuna e Gj.

Nga procedimi i dëshmitarëve A.(H.) K. nga fshati S., Komuna e Gj. dhe N. (I.) K. nga fshati M., Komuna e P., në mënyrë të padyshimtë, u vërtetua fakti se paditësi, ka qenë i martuar me të paditurën e lartpërmendur, të njëjtit kanë jetuar disa vite bashkë, nuk kanë pasur fëmijë dhe ka afro dy vjet që e kanë shkëputur bashkësinë faktike martesore prej të cilës periudhë kohore e tutje, të njëjtit jetojnë ndaras nga njëri tjetri.

Sa i përket zgjidhjes së martesës në mes të palëve në procedurë, kjo Gjykatë konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 68 par. 1 lidhur me nenin 69 par. 1 dhe par. 2 të Ligjit për

Familje të Kosovës (Ligji nr.34/32 i dt.20 janar 2006), meqë martesë e lidhur në mes të palëve në procedurë, e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilin është lidhë, si dhe faktit se : palët në procedurë ka mbi dy vjet që e kanë ndërprerë bashkësinë faktike martesore dhe që nga ajo kohë e tutje, të njëjtit jetojnë ndaras, ashtu që palëve në procedurë, iu ka humbur çdo kontakt qoftë edhe elektronik në mes veti dhe në këtë kontekst, martesë ka mbetur vetëm formalisht në mes tyre.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 450 të LPK-së, dhe deklarimit të autorizuarit të paditësit i cili pati sukses në procedurë, mirëpo të njëjtat nuk i kërkojë.

Nga të lartë cituarat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr.420/2017 datë 24.05.2018**

**KRYETARI I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARI,**  
**Ahmet Idrizaj**

**UDHËZIM JURIDIK;** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.